



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1110/ 5 Prot.,

Datë 21.05.2025

V E N D I M
Nr. 685 / 2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.05.2025 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Bajro Bros” ShPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, Mallra, me nr. REF-40956-03-12-2025, me objekt: “Materiale konsumi për oficinën TK”, me fond limit 1,600,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 02.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “AS INVEST” ShPK në procedurën e prokurimit sipërshtuar.

Lënien të skualifikuar dhe shtim të arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Luan Spahia Spahia” P.F në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Bajro Bros” ShPK me Nipt, NIPT M113130290, dhe adresë: Rr. Ndre Mjeda, Kompleksi rezidencial “Magnet”, Pallati Lura, njesi shërbimi nr.1017, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Portual Durrës.
Adresa: Lagjja Nr.1, Rruga Tregëtare, Durrës.

Subjekte të interesuar: Operatori ekonomik “AS INVEST” ShPK me NIPT M11803504B dhe adresë: Lagjja 13, Plazh, Z.Kadastrale 8518, Nr.Pasurie 58/338+1-43, kati 8. Durrës.

Operatori ekonomik “Luan Spahia Spahia” P.F, me NIPT L01807503L dhe adresë: Lagjja nr.13, plazh, Nr.pasurie 38/214- ND-N7, Z. Kadastrale 8518, Durrës .

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomikë ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë nëpërmjet sistemit pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datë 13.03.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Mallra, me nr. REF-40956-03-12-2025, me

objekt: “Materiale konsumi për oficinën TK”, me fond limit 1,600,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 02.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

II.2 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), rezulton se autoriteti kontraktor në datën 25.04.2025 ka përfunduar vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, në SPE dhe ka kryer renditjen e tyre si vijon:

Operatorët ekonomikë	Vlerat e ofertave	Vlerësimi
1- Bajro Bros Shpk	1,200,000	Skualifikuar
2- Luan Spahija P.F	1,470,900	Skualifikuar
3- 2AS INVEST Shpk	1,486,000	Kualifikuar

II.3. Nga verifikimet e kryera në SPE Autoriteti Kontraktor më datë **28.04.2025** ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit.

II.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5280, datë 29.04.2025 dhe me Nr. 1110/2025 Prot., datë 29.04.2025 e operatorit ekonomik “Bajro Bros” ShPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, Mallra. me nr. REF-40956-03-12-2025, me objekt: “Materiale konsumi për oficinën TK”, me fond limit 1,600,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 02.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar u konstatua se objekti i ankesës lidhet, me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Bajro Bros” ShPK, me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “AS INVEST” ShPK si edhe lënien të skualifikuar dhe shtim arsye skualifikimi për operatorin ekonomik “Luan Spahia Spahia” P.F në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit nr. 1110/1 prot., datë 30.04.2025, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë.

II.6. Me shkresën nr. 1298 Prot., datë 08.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1110/2 Prot., datë 12.05.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin e KSHA-së mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Bajro Bros” ShPK, për procedurën e prokurimit.

Referuar Vendimit sipërcituar KSHA ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.7. Referuar dosjes administrative, në referim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nuk janë paraqitur pretendime nga operatorë të interesuar për këtë procedurë prokurimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik,

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë, operatori ekonomik “Bajro Bros” ShPK, me anë të së cilës kundërshton vendimarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me arsyen e skulifikimit me argumenta si vijon:

“OE nuk ka ngarkuar ne SPE oferten teknike të ngarkuar nga AK ne SPE per produktet pjese e specifikimeve teknike. Per kete motiv AK e ka te pamundur te vleresoje permbushjen e specifikimeve teknike.

SE PARI ne asnje vend te DST te ketij tenderi nuk kerkohet paraqitja e Ofertes teknike nga OE.

SE DYTI nuk eshte i vertete citimi i KVO -se, se Dokumenti i ofertes teknike eshte pjese e specifikimeve teknike te ngarkuar ne SPE. Dokumenti i specifikimeve teknike se bashku me listen eshte dokument me vete i ngarkuar ne SPE dhe jo bashke me Oferten teknike (sic citohet nga KVO-ja).

SE TRETI, plotesimi dhe paraqitja e dokumentit oferte teknike nga OE, NUK eshte kerkuar dhe pasqyruar as ne procesverbalin e argumentimit te kriterëve dhe specifikimeve teknike (sic e kerkon ligji).

SE KATERTI, Citimi i KVO -se se: Per kete qellim AK e ka te pamundur te vleresoje permbushjen e specifikimeve teknike nuk eshte i sakte, sepse ne DT tek kerkesat e vecanta per kualifikim, AK, per te bere te mundur vleresimin e permbushjes se specifikimeve teknike, ka kerkuar paraqitjen e disa mostrave nga artikujt e preventivit:

III.1.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar Setin e Dokumenteve Standarde, Seksionin 1 Udhëzime për Operatorët Ekonomikë:

D. PARAQITJA DHE HAPJA E OFERTAVE

11. Paraqitja e Ofertave

11.1 Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, Operatorët Ekonomikë duhet të ngarkojnë ofertën e tyre në Sistemin e Prokurimit Elektronik, sipas përcaktimeve në manualët përkatëse.

11.2 Lidhur me procedurat e prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vetëm ofertën origjinale të mbyllur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për Furnizimin e Mallrave; Njoftimi Nr. ____.

“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR

**ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË
OFERTAVE, JO PËRPARA ----- d/m/v, në orën-----”**

**12. Afati i fundit për
paraqitjen e
Ofertave**

Oferta duhet të paraqitet brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Nëse autoriteti zgjat afatin kohor për pranimin e ofertave, operatorët ekonomikë, mund të paraqesin ofertat e tyre brenda afatit të zgjatur.

Data e hapjes së ofertave do të jetë e njëjtë me afatin e fundit të paraqitjes së ofertave. Nëse për arsye objektive, të shkaktuara nga një situatë e paparashikuar nga autoriteti kontraktor në kohën e fillimit të procedurës, është e pamundur të respektohet afati për hapjen e ofertave nga autoriteti kontraktor, arsyeja duhet të dokumentohet dhe të caktohet një datë e re për hapjen e ofertave.

Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, të cilët kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave, nëse janë të interesuar. Mosparaqitja e tyre nuk pengon hapjen e ofertave.

**13. Ofertat me
vonesë**

Autoriteti Kontraktor nuk merr në shqyrtim asnjë ofertë që vjen pas afatit të fundit për paraqitjen e tyre siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës. Sistemi i Prokurimit Elektronik nuk lejon paraqitjen e ofertave që janë në tejkalim të afatit të fundit për paraqitjen e tyre.

**14. Tërheqja,
Zëvendësimi dhe
Modifikimet**

1. Operatori Ekonomik mund ta tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë ofertën e tij, në cdo kohë deri përpara afatit të fundit të pranimin të ofertave.

2. Në procedurat e prokurimit të cilat zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose tërheqin ofertat e tyre me kusht që modifikimi ose tërheqja të bëhet para skadimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim, para datës së afatit të fundit për paraqitjen e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet: "**MODIFIKIM OFERTE**" ose "**TËRHEQJE OFERTE**".

3. Asnjë ofertë nuk mund të tërhiqet, zëvendësohet ose modifikohet pas afatit të fundit për paraqitjen e ofertave.

**15. Hapja e
Ofertave**

Ofertat hapen pas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar për pranimin e ofertave në dokumentat e tenderit.

E. SHQYRTIMI I OFERTAVE

16. Konfidencialiteti

Autoriteti kontraktor duhet të ruajë konfidencialitetin sipas përcaktimeve të nenit 16 të LPP-së.

**17. Sqarimi i
ofertave**

1. Autoriteti Kontraktor, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, mund të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomikë ofertues. Çdo sqarim i paraqitur nga Operatori Ekonomik që nuk i përgjigjet një kërkesë nga Autoriteti Kontraktor nuk do të merret në konsideratë. Nuk mund të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë

ndryshim në çmimet ose përmbajtjen e ofertave, përveç rasteve të konfirmimit të korigjimit të gabimeve aritmetike të konstatuara nga Autoriteti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertave.

III.1.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 20 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.3 Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtare.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet

kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmaturave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmaturat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësor.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.4. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

4. *Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.*

III.1.5 Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kriteret dhe specifikimet teknike të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistem dokumentacionin si vijon:

1-Formulari_i_Ofertes_dhe_Lista_e_cmimeve_APD

2-Deklarata_shtese_APD

Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit Komisioni konstaton se, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është kërkuar shprehimisht që të paraqitet ofertë teknike e cila do të shoqërojë ofertën ekonomike si pjesë plotësuese e saj e në rast mosparaqitjeje do të përbënte shkak skualifikimi. Gjithashtu referuar Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të publikuara në DST oferta teknike nuk bën pjesë si kriter kualifikim/skualifikimi për vlerësimin e ofertave.

Ndërkohë operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentacionin e formularit të ofertës sipas shtojcës përkatëse.

Komisioni thekson se Ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës së prokurimit. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve apo kërkesave të tjera, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar si kriter skualifikues, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik por çënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Akoma më tej në referim të nenit 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave*, rezulton se Autoriteti kontraktor gjatë fazës së vlerësimit të ofertave nuk ka kërkuar sqarim nga operatori ekonomik ankimues, në lidhje me dokumentacionin e paraqitur prej tij në sistemin e ankesave elektronike.

Me të drejtë ankimuesi ka argumentuar në ankesën e tij [...] Nëse është e nevojshme, KVO kërkon sqarime nga ofertuesit,.... Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë. Gjithashtu, AK është i detyruar që në vlerësimin e ofertave, të bazohet vetëm në kërkesat për kualifikim të DT.[....]

Komisioni gjithashtu sjell në vëmendje të Autoritetit Kontraktor momentin procedural të zbatimit të kontratës, kohë në të cilën ka mundësi të verifikojë dhe vlerësojë mallrat e dorëzuara nga operatori ekonomik fitues, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Në çdo rast mosplotësimi të kushteve të kontratës, autoriteti kontraktor zbaton penalitete për operatorin ekonomik.

Për sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik “Bajro Bros” ShPK qëndrojnë.

III.2. Lidhur pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues, për shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “AS INVEST” ShPK si edhe pretendimet për mbetjen të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Luan Spahia Spahia” P.F., në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni gjykon se nuk do të merren në shqyrtim, për faktin se referuar arsyetimit më sipër rezulton se në pikën III.1.5 të këtij vendimi KPP pranon ankesën duke përmbushur qëllimin e ankimuesit mbi kualifikimin e tij në procedurën objekt shqyrtimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Bajro Bros” ShPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Mallra. me nr. REF-40956-03-12-2025, me objekt: “Materiale konsumi për oficinën TK”, me fond limit 1,600,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 02.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Bajro Bros” P.F, duke e kualifikuar atë në zbatim të këtij vendimi.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Bajro Bros” ShPK
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

